



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02.Nr. 6291 2022

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Udhëzimit Administrativ 02/2019 për Organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane neni 12, në bazë të Rregullorës për Organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit, 01.nr.9274, numër 01.5349/2020, neni 14 dhe kërkesës së palës, me nr. 02 / 6167, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

## V E N D I M

Për kompensimin e kryetarëve të këshillave të fshatrave

1. Merret vendim për kompensimin e kryetarëve të këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit.
2. Këshillat e fshatrave në territorin e komunës së Hanit të Elezit përbëhen nga Katër (4) kryetar të këshillave të fshatrave, emrat e të cilëve do të jenë pjesë përbërëse e këtij vendimi me listën e zgjedhjeve të cilat janë mbajtur gjatë vitit 2022.
3. Kompensimi i kryetarëve të këshillave të fshatrave është ekuivalente me anëtarët e komiteteve të obligueshme të kuvendit të komunës, pagesa bëhet për mledhjet të cilat i mbajnë, por jo më shumë se gjashtë (6) mbledhje apo takime brenda vitit.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ekzekutohet nga Drejtoria për Buxhet dhe Finanaca.
5. Me këtë vendim njoftohet: Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkiva e Komunës.

Data: 08.08.2022  
Hani i Elezit

